



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

**Legjislatura VIII**  
**Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere**  
**Mbledhja nr.26/2023**  
**Prishtinë, më 20.9.2023, në orën 11:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Armend Muja, Mërgim Lushtaku, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti dhe Ferat Shala.

**Munguan:** Duda Balje dhe Pal Lekaj.

**Të ftuar:** Hekuran Murati, ministër i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Gazmend Syla, përfaqësues nga Thesari, Nazmi Berisha, drejtor, Dogana e Kosovës dhe Vesa Janova, nga Zyra ligjore e MFPT-së.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Sami Gashi, asistent GP-LVV, Elsa Krasniqi, asistente GP-LVV, Jeton Bajraktari, analist buxhetor-Kuvendi i Kosovës, Arbëresha Berisha, gazetare, RTK, Duresa Tafa, zyrtare, Kuvendi i Kosovës, Rron Ukaj dhe Fatbardh Kërçeli, praktikantë në Kuvendin e Kosovës.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Elfete Alshiqi-Beqiri, Sabrije Saliuki- Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

**Mbledhjen e kryesoi** Armend Muja, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura të Komisionit, më datë 21 qershor dhe 10, 26, 27 korrik 2023;
3. Miratimi i raportit të punës së Komisionit për Sesionin pranveror 2023;
4. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për Sesionin vjeshtor 2023;

5. Shqyrtimi i raportit plotësues, lidhur me raportin me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.08/L-211 për verëra;
6. Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2022;
7. Votimi i raportit vjetor financiar i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2022;
8. Votimi i raportit vjetor financiar i Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare për vitin 2022;
9. Votimi i raportit vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2022;
10. Vazhdimi-shqyrtimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022;
11. Shqyrtimi në parim i Projekt-Kodit nr.08/L-247 Doganor dhe i Akcizave;
12. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-253 për aderimin e Kosovës në Konventën për importin e përkohshëm;
13. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** paraqiti propozimin e deputetit Visar Korenica, që të bëhet një plotësim-ndryshim te rendi i ditës, që të inkorporohet shqyrtimi i raportit 6- mujor të Kuvendit të Kosovës për vitin 2023, si pikë e fundit e rendit të ditës.

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës, me ndryshimin e lartcekur.

### **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura të Komisionit, më datë 21 qershor dhe 10, 26, 27 korrik 2023**

**Kryetari** hodhi në votim procesverbalet dhe konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura të Komisionit, pa vërejtje.

### **3. Miratimi i raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2023, dhe 4. Shqyrtimi i planit të Punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2023**

**Kryetari** paraqiti raportin e punës së Komisionit, i cili tha se përmban të dhëna, informacione dhe shënime që pasqyrojnë aktivitetet e Komisionit, të realizuara gjatë periudhës janar-korrik (Sesioni pranveror) 2023, në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Gjithashtu i njoftoi anëtarët e Komisionit rreth draft-planit të punës për sesionin vjeshtor 2023.

**Avdullah Hoti**, propozoi që raporti i punës të krahasohet me planin e punës për 6- mujorin e parë të vitit 2023 dhe të raportohet lista e detyrave të cilat nuk janë përmbushur. Gjithashtu kërkoi informata shtesë te pika 6 e raportit, e cila ka të bëjë me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

**Kryetari:** Te mbikëqyrja e ligjeve është paraparë që këtë sesion të realizohet, sepse ka qenë edhe çështja e plotësimit të anëtarëve të Bordit dhe tash është momenti që ta kompletojmë.

**Mërgim Lushtaku:** Pajtohem që të paraqiten edhe vërejtjet e deputetëve në raportin e punës për sesionin pranveror 2023. Sa i përket grupeve punuese, në Ligjin për sigurimet e përgjithshme, kemi pasur disa rekomandime si grup punues.

**Kryetari** kërkoi nga administrata, që të plotësohet raporti i punës për Sesionin pranveror 2023, gjithashtu kërkoi nga anëtarët e Komisionit, që deri të hënën, me datë 25 shtator 2023, administratës t'i dërgohen propozime konkrete lidhur me planin e punës për Sesionin vjeshtor 2023.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni vendosi që miratimi i raportit të punës për Sesionin pranveror 2023 dhe shqyrtimi i planit të punës për Sesionin vjeshtor 2023, të bëhet në mbledhjen e radhës, pas inkorporimit të propozimeve.

## **5. Shqyrtimi i raportit plotësues, lidhur me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Projektligjin nr.08/L-211 për verëra**

**Kryetari:** Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim ka hartuar raport plotësues lidhur me raportin me amendamente për Projektligjin nr.08/L-211 për verëra. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të raportit dhe raportin me rekomandime e procedon te Komisioni funksional.

Pasi për këtë pikë nuk kishte diskutime, kryetari e vendosi në votim raportin dhe konstatoi se nuk ka vota të mjaftueshme për miratimin e raportit.

## **6. Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues i Prokurimit për vitin 2022**

**Kryetari:** Ju njoftoj se Komisioni, në cilësinë e Komisionit funksional, më datë 10, 17 maj dhe 26 korrik 2023, ka shqyrtuar raportin vjetor të OSHP-së, ndërsa Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, e ka shqyrtuar raportin e auditimit të OSHP-së, por nuk ka propozuar rekomandime konkrete për seancë plenare dhe as për OSHP-në, për shkak se ZKA ka dhënë opinion të pamodifikuar për pasqyrat financiare të OSHP-së, për vitin 2022.

**Jeta Statovci:** Një rekomandim ka qenë trajtimi më i shpejtë i ankesave dhe kërkesave, lista e zezë e operatorëve dhe ka pasur mospërputhje në deklarata mes KRPP-së dhe OSHP-së.

**Avdullah Hoti:** OSHP është një lloj kuazi gjykate. Ne duhet të jemi shumë të kufizuar në dhënien e rekomandimeve në bazë të kompetencave që kemi. Ne mund të jemi të pakënaqur me performancën e tyre, por nuk na takon të lëshojmë rekomandime.

**Kryetari:** Ka një afat 58- ditor, që është minimumi ligjor që të kthejnë përgjigje për ankesat, është rekomandim që e ka dhënë edhe opozita, që të respektohet afati ligjor.

**Jeta Statovci:** Është në interes të publikut, në mënyrë që operatorët të trajtohen drejt dhe të mbahen përgjegjës operatorët që nuk tregohen të përgjegjshëm. Nuk po kërkohet asgjë më shumë sesa përgjegjësi që derivon nga ligji.

**Eman Rrahmani:** Duhet të jemi më korrekt, sa i përket kërkesës së OSHP-së për shtimin e stafit. Në secilin raportim, ata kanë kërkuar rritjen e stafit dhe ne si Kuvend nuk i kemi pranuar këto kërkesa. Nëse i gjykojmë ata, duhet ta gjykojmë edhe veten tonë, sepse ata kanë deklaruar se me atë staf që kanë, është e pamundur proceduralisht, që t'i kryejnë punët që kanë. Jam i pakënaqur me performancën e tyre. Nëse e marrim totalin e lëndëve dhe të stafit, është e pamundur, sepse secili rast duhet të hetohet. Si konkluzion, për buxhetin e vitit të ardhshëm, të rishikohet mundësia për rritjen e stafit. Ka qenë gabim mospërmbushja e kërkesës për plotësim të stafit.

**Kryetari:** Mund t'i inkorporojmë në rezolutë, 3 vërejtjet e anëtarëve të cekura më lart. Meqë ky është një organ kuazi gjyqësor, këta duhet të nivelohen me sistemin gjyqësor, sa i përket pagesave. Së shpejti fillojmë dëgjimet buxhetore dhe do të kemi mundësi që t'i referojmë këto rekomandime.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se në mungesë të kuorumit, votimi i raportit të OSHP-së për vitin 2022, shtyhet për mbledhjen e radhës.

## **7. Votimi i raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2022**

**Kryetari:** Ju njoftoj se për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit, më datë 26 korrik 2023, andaj sot e vendos në votim raportin. ndërsa raportin ia adresojmë Komisionit funksional. Te Ligji për KPM-në, është që institucionet nuk mund të licencohen, nëse nuk e kanë paguar taksën e licencës. Unë insisto që të zbatohet, për shkak se borxhet e akumuluar duhet të fillojnë të trajtohen.

**Visar Korenica:** Kur kanë qenë në raportim anëtarët e KPM-së për pasqyrat financiare, i kam pyetur se ku janë me rastet në përbarim dhe nuk kam marr përgjigje të saktë. Borxhet duhet të inkasohen, nëse ligji e parasheh t'iu hiqet licenca, t'iu hiqet, nëse nuk e parasheh, të dërgohen në përbarim.

**Kryetari:** Borxhliu më i madh i KPM-së është RTK, duhet ta trajtojmë përmbajtësisht çështjen e këtyre institucioneve publike që i kanë borxh njëra-tjetrës. Duhet ta ndihmojmë RTK-në, që ta shlyejë borxhin, por kjo vendos një precedent të keq. A ka sugjerime të tjera?

**Mërgim Lushtaku:** Te raporti i KPM-së kemi dhënë disa rekomandime. Disa vërejtje kanë qenë edhe te pjesa e qirasë. Derivatet për gjenerator kanë qenë të mëdha dhe shpenzimet e planifikuara. Te KPM, edhe pse e kemi shqyrtuar pjesën buxhetore, pjesa e dixhitalizimit nuk është realizuar, nuk është përgjegjësi vetëm e Qeverisë, kjo është përgjegjësi edhe e Kuvendit.

**Kryetari:** Pas përfundimit të diskutimeve, konstatoi se në mungesë të kuorumit, votimi i raportit të KPM-së për vitin 2022, shtyhet për mbledhjen e radhës.

## **8. Votimi i raportit vjetor financiar i Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare për vitin 2022**

**Kryetari:** Ju njoftoj se për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit, më datë 26 korrik 2023, andaj sot e vendos raportin në votim. Kam të njëjtat vërejtje sikurse te KPM. Edhe tek ARKEP kemi problemin e njëjtë, ku publikja nuk e respekton publikën, është vërejtja e njëjtë, nuk janë shlyer detyrimet për licencën.

**Mërgim Lushtaku:** Vërejtja mbetet te pjesa e implementimit të buxhetit, shihet qartë që nuk i ka arritur objektivat e veta.

**Kryetari:** Inkasimi ishte më i ulët se në vitin paraprak dhe nuk ka pasur asnjë shpjegim.

**Jeta Statovci:** Me rastin e cilësisë së internetit, kam shtruar pyetje sesi shkojnë procedurat e brendshme, lidhur me zonat e caktuara, ku nuk mbulohen me rrjet dhe konsumatori paguan, ndërsa ka qenë kërkesë që t'i monitorojë ARKEP.

**Kryetari:** Një kërkesë e imja ka qenë për “Dardafon” dhe nuk kam marrë një përgjigje për këtë, me kë ka qenë raporti juridik?

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se në mungesë të kuorumit, votimi i raportit të ARKEP-it për vitin 2022, shtyhet për mbledhjen e radhës.

## **9. Votimi i raportit vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2022**

**Kryetari:** Ju njoftoj se për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur të Komisionit, më datë 10 maj 2023, andaj sot e vendos në votim raportin.

**Avdullah Hoti:** Ne e kemi mbaruar raportimin, por në muajt e fundit ka pasur aq shumë zhvillime sa e përmbysin këtë raport. Gjoha të njëpasnjëshme të inspektoratit, konkurset e paligjshme, 11,000 euro është dënuar RTK për veprime të menaxhmentit që organet kompetente i kanë shpallur të paligjshme. Nëse është e mundur, diskutimin ta mbyllim me një raportim të tyre. Gjithashtu, gjysma e punëtorëve kanë nënshkruar peticion për kryetarin e Bordit.

**Kryetari** propozoi që në mbledhjen e radhës, sipas propozimit, të ftohet Bordi i RTK-së, që të vazhdohet me shqyrtimin e raportit vjetor dhe të shqyrtohet bashkërisht me të edhe raporti i shpenzimeve të RTK-së, për periudhën prill-qershor 2023.

## **10. Vazhdimi-shqyrtimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022**

**Kryetari:** Në bazë të nenit 46 të Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ministri i Financave e përgatit dhe ia dorëzon Qeverisë, për miratim dhe dorëzim në Kuvend, një raport përfundimtar përmbledhës të buxhetit për vitin e kaluar fiskal dhe dy vitet paraprake fiskale. Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendim nr.12/136, më datë 22.3.2023 ka aprovuar raportin vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe e ka proceduar në Kuvend, i cili më datë 24.3.2023 u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit. Ndërsa, me Vendimin nr.17/153 të datës 26.7.2023, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka ri-aprovuar raportin vjetor financiar për vitin 2022, i cili më datë 28.7.2023 u është shpërndarë deputetëve dhe Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit funksional, është ngarkuar që ta shqyrtojë raportin vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe Kuvendit t’i paraqesë raport me rekomandime.

**Ministri** prezantoi raportin dhe shtoi se pas procesit të auditimit, janë bërë disa korrigjime teknike, që kanë qenë të nevojshme.

**Avdullah Hoti:** Kam kërkuar shpjegim për avancën për investime kapitale dhe përgjigja ka qenë kërko nga ministrinë përkatëse. Më intereson ku kanë shkuar 80 milionë euro avancë për investime kapitale, të cilat nuk kanë ndodhur? Kur ia heq këto, vlera e investimeve bie në 340 milionë. Pse janë dyfishuar subvencionet?

**Ministri:** Ju kemi shkruar të kërkonit, sepse në nivelin e furnitorit, përgjigjet ministria, ne vetëm raportojmë. Sa i përket rritjes, është kryesisht për shkak të avanceve të sigurimit të nevojshëm të sistemeve për FSK-në.

**Avdullah Hoti:** Nëse nuk përgjigjeni, ju më detyroni të përdor ligjin për qasje në dokumente publike. Jeni të obliguar t'i dërgoni në afatin ligjor. Informatat që kam kërkuar për subvencione dhe avance për investime kapitale nuk janë sekret shtetëror. Nuk është e zakonshme për të paguar avance 20 herë më shumë për investime kapitale.

**Kryetari:** Në raportimin e kaluar kam pasur dy kërkesa, f. 79, çdoherë në raportin financiar janë 184 milionë obligime të papaguara nga shpronësimet. A mund ta kem një raport të detajuar nga viti 2012 e këndeje, se kur janë regjistruar këto shpenzime? Kam kërkuar shpjegim të llogaritë të arkëtueshme, KPMM ka llogari 30 milionë për 5-6 vitet e fundit, a regjistrohen këto, a i dërgon në Thesar apo vetëm në fundvit e merrni një raport? KPM po ashtu 759 mijë euro, Autoriteti i Aviacionit Civil 407 mijë euro. Gjatë raportimeve i kam kërkuar kur janë regjistruar këto fatura dhe janë të vjetra. E njëjta është edhe te komunat. Rezervat te BQK.

**Ministri:** Mbahen, sepse na ndihmojmë të amortizojmë në raste krizash, për shkak të mungesës së politikës monetare dhe valutës. Edhe kur rritet rezerva, është e nevojshme.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se në mungesë të kuorumit, votimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, shtyhet për mbledhjen e radhës.

## **11. Shqyrtimi në parim i Projekt- Kodit nr.08/L-247 Doganor dhe i Akcizave**

**Kryetari:** Në bazë të nenit 74, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare, Komisioni përgjegjës-raportues e shqyrton projektligjin në parim dhe Kuvendit i paraqet raportin me rekomandime. Qeveria e Republikës së Kosovës ka proceduar në Kuvend Projekt- Kodin nr.08/L-247 Doganor dhe i Akcizave. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, si Komision funksional, është ngarkuar që të shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

**Ministri:** Projekt-Kodi Doganor siguron një kornizë gjithëpërfshirëse për rregullat dhe procedurat doganore në territorin doganor të Republikës së Kosovës, duke përshtatur zhvillimet e fundit në fushën e tregtisë dhe mjetet moderne të komunikimit, duke siguruar sistem plotësisht të automatizuar. Për të arritur këtë objektiv, Dogana e Kosovës (DK) duhet të përmirësojnë disa sisteme elektronike ekzistuese dhe të prezantojnë disa të reja për përfundimin e të gjitha formaliteteve doganore. Me këtë projektligj synohet që operatorët ekonomikë të përfitojnë plotësisht nga teknologjia e informacionit, e cila do të mundësojë reduktimin e barrës dhe shpenzimeve dhe do të përmirësojë efektivitetin e kontrolleve doganore (krijimin e balancit në mes kontrolleve dhe lehtësirave tregtare).

**Avdullah Hoti:** Kisha sugjeruar edhe të pjesa e tatimeve të shkojmë me kod doganor. Cilat janë ndryshimet kryesore në kodin doganor, nëse mund të sqaroni cilat janë dy-tri ndryshimet që e prekin rregullimin e administratës? E lexova memorandumun shpjegues, nuk ka asnjë shpjegim. Nuk kam parë që është mbajtur asnjë konsultim publik. A janë kryer konsultimet publike, dhe nëse po, është dashur të përfshihen sugjerimet në memorandum? Me sa kam informata nuk janë bërë. Nuk është shqyrtuar në Këshillin Kombëtar Ekonomik. Cili është qëndrimi juaj karshi idesë që të kalohet mbledhja e TVSH-së brenda, a e mbështesni ende këtë ide? Në pikën doganore në Durrës, si e menaxhoni këtë kod doganor?

**Ministri:** Kodi doganor përbëhet nga 6 libra. Mbledhja ose jo e TVSH-së, në brendi, nuk përcaktohet domosdo. Faturimi i centralizuar i TVSH-së nuk është kusht që të ketë ndryshim të strukturës së ATK-së. Për ne është e rëndësishme që të bëjmë ndryshimin e sistemit. Sa i përket portit të Durrësit, kodi trajton

njëjtë, sikurse çdo pikë tjetër doganore dhe nuk ka nevojë për emërtim të veçantë, sepse përfshihet në territorin doganor.

**Nazmi Berisha:** Ndryshimet në kodin doganor reflektojnë nga direktivat e BE-së. Sa i përket portit të Durrësit, është marrëveshje ndërkombëtare dhe nuk interferon me kodin doganor.

**Avdullah Hoti:** Bashkësitë fetare kanë trajtim të veçantë, në veçanti për kafshët dhe produktet bujqësore, e keni pasur për kishën serbe. A e keni pasur parasysh këtë, përderisa e keni potencuar?

**Nazmi Berisha:** Kisha ortodokse serbe ka kërkuar që të zgjerohet aktiviteti. Sa i përket akcizës, nuk do të ketë lirim, përveç me ndonjë vendim të qeverisë.

**Avdullah Hoti:** Po kujdeseni për t'i zbatuar provizionet që burojnë nga Pako e Ahtisarit?

**Ministri:** Detajizimi është për shkak të kufizimit, sepse kur nuk detajizohet, mund të hyjë gjithçka.

**Kryetari:** Ligji për liri fetare, i propozuar qeveri pas qeverie, i përfshin këto provizione. Sa i përket personave me aftësi të kufizuara, që kanë vështirësi në zhdoganimin e pajisjeve, a janë përfshirë kërkesat e tyre? A është paraparë që regjistrimi i mallrave të bëhet në mënyrë dixhitale?

**Nazmi Berisha:** Bëhet edhe tash, por tash edhe vendimet dhe çdo veprimtari do të kryhet në mënyrë të dixhitalizuar. Kemi pasur takime me shoqata të personave me aftësi të kufizuara. Pajisjet që iu nevojiten janë të liruar nga dogana. Kërkesa ka qenë që në ligjin për persona me aftësi të kufizuara, të precizohet kjo, por meqë nuk është bërë, ne i kemi ruajtur lirimet doganore.

**Eman Rrahmani:** A është paraparë rritje e akcizës për ndonjë produkt?

**Nazmi Berisha:** Ky projekt-kod nuk i rregullon normat e akcizës, por vetëm procedurën.

**Mërgim Lushtaku:** Te pjesa e mbledhjes së TVSH-së, a keni ndonjë planifikim, si keni menduar të veproni?

**Ministri:** Çështja e TVSH-së rregullohet me Ligjin për TVSH-në, ku edhe përcaktohet.

**Mërgim Lushtaku:** Sa është e rregulluar për shoqatat bamirëse?

**Nazmi Berisha:** Po, është e rregulluar nëse janë të regjistruara si shoqata bamirëse.

**Kryetari:** A keni bërë ndonjë ndryshim te rregullat e origjinës?

**Nazmi Berisha:** I zbatojmë rregullat e origjinës.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se në mungesë të kuorumit, votimi në parim i Projekt-Kodit nr.08/L-247 Doganor dhe i Akcizave, shtyhet për mbledhjen e radhës.

## **12. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-253 për aderimin e Kosovës në Konventën për importin e përkohshëm**

**Kryetari:** Në bazë të nenit 83, paragrafi 5 të Rregullores së Kuvendit, projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare e shqyrton Komisioni përgjegjës-raportues. Qeveria e Republikës së Kosovës

ka proceduar në Kuvend Projektligjin nr.08/L-253 për aderimin e Kosovës në Konventën për importin e përkohshëm, për të cilën Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, si Komision funksional, është ngarkuar që ta shqyrtojë projektligjin dhe të paraqesë raportin me rekomandime për Kuvend. Lidhur me këtë pikë kemi ftuar ministrin e Financave, z. Hekuran Murati, nga i cili kërkojmë që të prezantojë dhe të arsyetojë projektligjin.

**Ministri** prezantoi marrëveshjen dhe shtoi se çështja kryesore e trajtuar në këtë projektligj është aderimi i Republikës së Kosovës në Konventën për Importin e Përkohshëm, bërë në Stamboll, më datë 26 qershor 1990, e ndryshuar në Bruksel, më 26 korrik 2010, 15 maj 2014 dhe 29 nëntor 2016. Me qëllim që Republika e Kosovës të zhvillojë tutje lehtësimin e procedurave doganore, e konsideron të nevojshme që si hap të ardhshëm të bëhet palë kontraktuese në “*Konventën e Stambollit për Importin e Përkohshëm*” (bërë në Stamboll, më 26 qershor 1990). Republika e Kosovës, në vitin 2020, ka aderuar në dy konventa ndërkombëtare të administruara nga Organizata Botërore e Doganave, ndërsa me aderimin në Konventën e Stambollit, do të bëhemi shteti i 75-të në botë, si palë kontraktuese. Konventa e Stambollit për lejim të përkohshëm ofron dispozita uniforme, duke siguruar në nivel të lartë thjeshtëzimin dhe harmonizimin e procedurave doganore për mallra dhe mjete transportuese, që përdorin procedurën e importit të përkohshëm. Në këtë Konventë kanë aderuar 74 shtete, si palë kontraktuese, përfshirë këtu të gjitha shtetet e rajonit.

Pasi për këtë pikë nuk kishte diskutime, kryetari konstatoi se në mungesë të kuorumit, votimi i Projektligjit nr.08/L-253 për aderimin e Kosovës në Konventën për importin e përkohshëm, shtyhet për mbledhjen e radhës.

**Kryetari**, gjithashtu konstatoi se në mungesë të kuorumit, shqyrtimi i raportit të shpenzime të Kuvendit për 6- mujorin e parë të vitit 2023, shtyhet për mbledhjen e radhës.

**13.Të ndryshme.**

Pasi në këtë pikë nuk kishte ndonjë çështje për diskutim, kryetari e mbylli mbledhjen.

**Mbledhja përfundoi në orën 14:00.**

**E përgatiti: Staf i mbështetës i Komisionit**

**Armend Muja,**

-----

**Kryetar i Komisionit**